



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

63,69/21
12.03.2021

PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr.63/21
69/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik N.T.SH “NODE TECH” - Suharekë dhe OE N.P.SH “AFA ING KING” sh.p.k- Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE CIMI @ Electronics sh.p.k- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me paisje teknologjike (Komjutura ,komplet,fotokopje ,kamera te sigurise ,printera,videoprojektore dhe pajisje tjera” me nr. të prokurimit: 624-20-5060-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Suharekë, më datën: 11.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH “NODE TECH” - Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me paisje teknologjike(Komjutura ,komplet,fotokopje ,kamera te sigurise ,printera,videoprojektore dhe pajisje tjera” me nr. të prokurimit: 624-20-5060-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë.

II. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.P.SH “AFA ING KING” sh.p.k- Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me paisje teknologjike(Komjutura ,komplet,fotokopje ,kamera të sigurise ,printera,videoprojektore dhe pajisje tjera” me nr. të prokurimit: 624-20-5060-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë.

III. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me paisje teknologjike(Komjutura ,komplet,fotokopje ,kamera të sigurise ,printera,videoprojektore dhe pajisje tjera” me nr. të prokurimit: 624-20-5060-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, dhe anulohet ne tërësi aktiviteti i prokurimit.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.T.SH "NODE TECH" – Suharekë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.P.SH "AFA ING KING" sh.p.k- Suharekë i refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

VIII. Obligohet operatori ekonomik ankues N.T.SH "NODE TECH" – Suharekë që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues N.T.SH "NODE TECH" - Suharekë dhe OE N.P.SH "AFA ING KING" sh.p.k- Suharekë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 10.11.2020 me nr. 63/21, dhe me datë 02.01.2021 me nr. 69/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, prokurimit me titull: "Furnizimi me paisje teknologjike (Komjuter, komplet, fotokopje, kamera të sigurisë, printera, videoprojektore dhe pajisje tjera" me nr. të prokurimit: 624-20-5060-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 28 dhe nenin 59 të LPP-së, te ankesa me nr. 63/21.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 56.3, 59 dhe nenin 60 të LPP-së, te ankesa me nr. 69/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 25.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datë: 01.02.2021, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ve ankues sqaron si në vijim:

Konsideroi se kjo lende tashme është trajtuar me raportet përkatëse me numër 917 - 937 për të cilat janë lëshuar edhe vendimet përkatëse nga OSHP me çka bazuar në dokumentacionin e Dosjes nuk rezulton se AK të këtë kërkuar sqarimet sipas vendimeve të OSHP-së, duke mos kërkuar sqarime shtese për pikat përkatëse. Për informimin e juaj me poshtë gjeni prapë mendimet e njëjta të cilat janë shqyrtuar tashmë.

Pretendimet dhe përgjigjet për lenden 917 -20 Node Tech

Pretendimin Ankimor 1.

Kërkesa1- Kërkesa1- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar projekte të ngjashme në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerën prej së paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese të këtyre projekteve. Për këtë pikë ne kemi ofruar dëshmi Listën e projekteve dhe referencat dhe Referencat në vlerën: 155,624.80 euro d.m.th. ne kemi ofruar shumë më shumë dëshmi se sa është kërkuar, nëse për AK është diçka e pa kuartë në listën dhe dëshmi konform nenit 72 të LPP-së është dashur me kërkuar sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej: 4,942.50 euro.

Përgjigje në pretendimin Ankimor 1

Bazuar në Ofertën e OE Node Tech përkatësisht Listës së Kontratave/referencave të ofruar rezulton se Kontrata e ofruar dhe Referencat e plotësojnë kriterin sipas dosjes së Tenderit. Andaj konsideroi se ky pretendim është i Bazuar.

Pretendimi Ankimor nr. 2

Kërkesa 2 - Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Staf i kualifikuar në fushën përkatëse, së paku -Një(1) Inxhinier të elektronikës, së paku 3 vite përvojë pune pas Diplomimit. Në këtë pikë fillimisht nuk keni kërkuar Inxhinier të diplomuar, po vetëm inxhinier, përkundër kësaj për këtë pikë ne kemi ofruar MASTER, z. Xhevat Berisha i cili me dëshmitë e tij i plotëson kërkesat e FDT-së. Në CV ju e keni vërejtur se ky inxhinier është Master, figuron në listë siç është kërkuar, nëse e keni patuar të pa qartë dhe këtë pikë është dashur konform nenit 72 të LPP-së të kërkonin diplomën Master të cilën po ua ofrojmë me këtë kërkesës për sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej 4,942.50 Euro Pas kërkesës për rishqyrtim nga ana jonë, për pikën e inxhinier të elektronikës për të cilën jemi eliminuar, çuditërisht në Vendimin e datës 06.11.2020 AK ka cekur se na mungon Inxhinier i Shkencave Kompjuter, për të cilën pikë ne kemi ofruar stafin dhe dëshmitë e për të cilën vet AK nuk ka kemi eliminuar, sepse dëshmitë janë pjese e ofertës tone!!!

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2

Bazuar në dokumentet e dosjes së ofertës për z. Xhevat Berisha, të njëjtit kanë ofruar dokumentacion si: Diplome Bachelor i Shkenca të Inxhinierisë Elektrik, ku i njëjti mbanë datën e diplomimit me datë 03 dhjetor

2013 në Departamentin Elektronik, Bazuar ne kërkesat se dosjes se Tenderit: Kërkesa2 – Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku –Nje (1) Inxhinier te elektronikes, se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit Një (1) Inxhinier i shkencave kompjuterike ,se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia2 - Kontratat e punës ose marrëveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV. Rezulton se i njëjti nuk përmbush kërkesën e AK-së pasi nuk plotëson kriterin bazë sepse ka Gradën Bachelor dhe jo Inxhinier ashtu siç edhe kërkohet në Kërkesën e AK-së.

Në lidhje me këtë pretendim ankimor OE do të duhej të parashtrohte kërkesë për sqarime shtesë gjatë fazës së Njoftimit për kontratë dhe jo vetëm pas vlerësimit te Ofertave. Andaj konsideroj se ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Pretendimet dhe përgjigjet për lëndën 937 -20 AFA-ING

Për informimin e juaj me poshtë gjeni prape mendimet e njëjta te cilat janë shqyrtuar tashme.

Përgjigje ne pretendimin Ankimor 1

Bazuar në Ofertën e OE AFA-ING;”K-ING” sh.p.k përkatësisht ISO Standard 9001:2015. OE në fjalë ka ofertuar me ISO Standard 9001:2015, Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave; Rrjete të ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimi i impianteve për trajtim të ujërave të zeza, rrugëve dhe urave. Ndërsa Projekti në fjalë ka të bëjë me Furnizim me Pajisje të TI-së, gjë që një Standard i tillë i ofruar nuk ka asnjë lidhshmëri me projektin, andaj konsideroi se ky ISO Standard i ofruar nuk plotëson kërkesat për këtë projekt.

Pretendimi ankimor nr. 2

Sa i përket arsyetimit tuaj se nuk kemi ofruar dëshmitë lidhur me stafin, konkretisht me inxhinierin e shkencave kompjuterike, kërkojmë nga ju të verifikoni edhe një here sepse dëshmia lidhur me këtë inxhinier gjendet në ofertën tonë të dorëzuar në sistemin e e-prokurimit. dëshmitë për këtë inxhinier janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Përgjigje ne pretendimin Ankimor 2

OE në fjalë rezulton se për këtë projekt ka ofruar stafin si në vijim: Ardian Morina – Diplome e ciklit të parë të Studimeve Universitare. Në dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi të jetë Master apo ING ashtu siç kërkohet në FDT. Bilbil Haxhijaha –Bachelor of science në dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi të jetë Master apo ING ashtu siç kërkohet në FDT. Florim Morina – Bachelor i shkencave të inxhinierisë elektrike, në dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi të jetë Master apo ING ashtu siç kërkohet në FDT. Izet Buzha – Inxhinieri i diplomuar i Elektronikës, Florian Mucolli - bazuar ne CV e të njëjtit dhe dokumenteve përcjellëse rezulton se: Posedon diplomë Bachelor në drejtimin: Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, November

2012 (Eworking on Master Thesis) – nuk ka dëshmi se ka të përfunduar Master. Konsideroj se në lidhje me këtë, AK do duhej konform nenit 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtese për dëshmitë e të njëjtit pasi në dosjen e ofruar nuk ka Diplome Master, mirëpo ne CV ceket: November 2012 (Eworking on Master Thesis).

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 01.02.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 03.02.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Sqarim: Eksperti në raportin lidhur pretendimet e OE Node Tech nuk qëndrojnë ngase eksperti ka shqyrtuar pretendimin lidhur me çështjen e kontratave dhe referencave ku për këtë çështje nuk është eliminuar OE në fjalë. AK ka bashkëngjitur dëshminë : Vendimin e AK

Operatori ekonomik “NODE TECH ”SH.P.K-Prishtinë, me datë 02.02.2021 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ne kem pranuar emailin nga ju por nuk pajtohemi dhe si duket po keqkuptohemi sepse inxhinieri i elektronikës i kërkuar nga AK ka krijuar huti pasi që pas futjes së sistemit të Bolonjes nuk ka më inxhinier ka vetëm bachelor dhe master e jo siç ka qenë me parë ing dhe ing i dip.

Kërkesa e AK -se ka qen inxhinier i pa diplomuar dhe atë e plotëson sistemi bachelor por megjithatë personi i ofruar nga ne ka të mbaruar edhe studimet master në fushën e mekatronikës gjë që Mekatronika integron fushat klasike të inxhinierisë elektrike, inxhinierisë kompjuterike ,inxhinierisë mekanike dhe teknologjinë informative ,gjë që mund të verifikohet .

Ne kem kërkuar qasje në dokumentacion dhe aty kem vërejt se inxhinieri i ofruar nga kompania e menduar për tu shpërblyer me kontrate ka të mbaruar shkollën e lart teknike në Mitrovicë dhe atë në elektroteknike e jo në elektronikë gjë që ndryshon situata e po ashtu ne e dimë që në shkollën e lartë teknike studimet zgjasin vite ndërsa në bachelor 3 vite e po ashtu Xhevat Berisha (inxhinieri i ynë) ka saktësisht të përfunduara studimet në fushën e elektronikës siç është kërkuar nga autoriteti kontraktues. Krejt në fund ne kërkojmë që kjo kontratë të anulohet dhe të rishpallet dhe të mos dëmtohem ne dhe buxheti dhe mos ta shpërblehet një kompani që nuk i përmbush kriteret sipas nesh. Si dëshmi po ju bashkëngjisë edhe diplomat e ing. të kompanisë së propozuar për kontratë dhe kompanisë sonë.

Operatori ekonomik N.P.SH "AFA ING KING" sh.p.k- Suharekë, me datë 03.02.2021 me anë të parashtrës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Sqarime shtesë:

Me datë 02.02.2020 kemi pranuar raportin e ekspertizës të cilin e kundërshtojmë në tërësi pasi që i njëjti nuk i ka trajtuar pretendimet tona siç është i obliguar me nenin 113 të LPP ,një raport i tillë i eksperti diskriminues dhe i njëanshëm. Bashkangjitur gjeni ankesën për të cilën eksperti nuk i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore .

Bashkangjitur gjeni Diplomën e noterizuar dhe vendimin e Ing, si dhe ISO standardin e kërkuar nga AK po të njëjtat dokumente i keni të ngarkuara ne e prokurim. Ju rikujtoj që një diplomë me studime 5 vjeçare është e barasvlershme me master bazuar ne ligjin për arsim të lartë.

Ne i plotësojmë në tërësi kërkesat e AK-së dhe jemi të përgjegjshëm për këtë aktivitet prokurimi.

Sa i përket ISO certifikatës ne edhe ne ankesë e kemi potencua se AK ka kërkuar vetëm ISO 9001:2015 Certifikatë ku ne i kemi bashkangjitur këtë certifikatë dosjes tone mirëpo, eksperti shqyrtues kërkon diçka me tepër se sa kërkesat ne FTD ,gjë që nuk është përcaktuar veprimtaria për të cilën kërkohet kjo certifikata dhe AK ka mundur ta kërkojë përmes nenit 72 të LPP- se.

Raportin të cilin e ka përgatitur Eksperti Shqyrtues nuk pajtohemi pasi që i njëjti raport është diskriminues dhe jo profesional pasi që i njëjti nuk i ka shtjelluar pretendimet tone të specifikuar pike për pike . Arsyetimin se eksperti shqyrtues ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, sepse i njëjti ka dal jashtë kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. I njëjti ekspert nuk ka shqyrtuar në tërësi kërkesat tone për ankim, Ne dosje të tenderit tek pjesa kapaciteti teknike dhe profesional është kërkuar ISO certifikata 9001:2015 të cilën e kemi dorëzuar në ofertë. ndërsa eksperti tani kërkon veprimtari adekuate e cila nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, pra eksperti është në kundërshtim flagrant me nenin 56.3 të LPP-së-. Sa u përket inxhinierëve ju lutem referojuni kërkesave të dosjes së tenderit në lidhje me stafin. ne asnjë pike tek kërkesat për stafin NUK janë kërkuar gradat master siç pretendon eksperti, nga kërkesat themelore të FTD-se. Gjithashtu eksperti nuk e ka shtjelluar piken tone ankimore ndaj OE se të propozuar për kontratë pasi që i njëjti i ka vu në lajthitje komisionin krahasues të ofertave me dy lloje të katalogëve të ndryshme. Prandaj kërkojmë nga paneli që këto dy pika të analizoj tek pjesa : kërkesat e dosjes së tenderit dhe të marr vendim meritore lidhur me ankesën tone sepse dëshmitë janë sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Ju lutem konfirmojeni pranimin e emailit !

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.02.2021, të mbajtur në ZOOM në ora 11:30, ku mori pjesë si panelist individual, përfaqësuesit e OE-së ankues "NODE TECH "SH.P.K, përfaqësuesit AK-së, eksperti shqyrtues, ndërsa përfaqësuesi i OE Afaing nuk ka qenë prezent në seancë, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga:

autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Gjate prezantimit ne seancë përfaqësuesit i OE "Node tech" deklaroi : unë do ti bije shumë shkurt se pse jemi me çmim ma te ulet edhe ne, na është kontestua inxhinieri i elektronikës na faktikisht ka disa vite qe nuk ka bachelor dhe master, inxhinieri jon posedon baqellor ne elektronik ka master ne informatikën elektroniken dhe makineritë, pas kërkesës qe kemi bere për qasje ne dok mundtë te OE te rekomanduar për dhënie te kontratës ne kemi vrenjt qe OE i propozo për shpërblim me kontratë posedon një diplomë pikërisht inxhinier i elektronikës a ne certifikata është inxhinier i elektroteknikës gjithë qe e ndryshon posedon një diplomë te shkollës se lart e cila nuk është e domosdoshme as për inxhinierin e propozuar nga ana jone. Kështu qe unë mendoj pasi kemi çmimi me te ulet pasi qe inxhinieri jone është pikërisht inxhinier i elektronikës sipas kërkesës se AK këtu është kontesti jone kërkojmë qe ankesa te merret si bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Kur tha se posedon diploma master te mekatronikës dmth ka diplomë master qe na e kemi sqarua dmth gjatë kërkesave tona qe e posedon mekatronika përfshin elektron dhe përfshin informatikë edhe përfshin makineri dmth kjo nëse një inxhinier i te messe kufizuar ka një shkollë te lart te Mitrovicës se titos shkolla e lart siç e dimë propozoj për mu shpërblje me kontratë apo qe ka përvoja tre vjeçar apo adekuat inxhinier bachelor i elektronikës se ja dy gjana t ndryshme elektroteknika dhe elektronika janë dy gjana te ndryshëm këtu është kërkuar inxhinier i elektronikës gjithë qe nuk kanë pas te drejt për arsyeje se ka vite e vite universitete tona edhe kolegjet nuk ofrojnë titullin inxhinier ofrojnë bachelor ofrojnë master, inxhinier i pa diplomuar është sipas meje është i barazvlefshum me një bachelor ndërsa një inxhinieri diplomua qe ka qen me par është me mister pra ka rekomandua një me shkollë te lar shkruan ne thotë shkollë e lart. Krekës e jon së paku te anulohet dhe te rishpallet.

Gjate prezantimit ne seancë përfaqësuesit i AK-së z. Bytyqi deklaroi: ne nuk jemi pajtue me ekspertizën e ekspertit për shkak se ne ankesë ka pas tjetër pretendime ndërsa eksperti ka shqyrtua pretendim tjetër qe nuk është ne ankesë ndërsa sa i përket çështjes se inxhinierit te cilën pala ankuese pretendon nuk e plotëson këtë kriter kjo është vërtetu edhe me vendimin e OSHP-së te datës 15.12.2020 me nr. te protokollit 917-931/20, ndera pretendimi herës se par qe ka qen procesi ne kontratë ka te bej me referencat dhe te pretendim e kemi aprovuar mbas vendimit te OSHP-së dhe rekomandimi i ekspertit është than qe shkak i këtij pretendimi te kontratat dhe referencat te kthehet ne rivlerësim dmth këtë pretendim e ka marr si te bazushem ndërsa OE ankues nuk është i eliminim për këtë pretendim. Dhe kontratat dhe referencat e OE ankues nodetech e plotëson kriterin nuk është eliminuar për këtë çështje ndërsa ne raport te ekspertit thuhet se ky tejkalon vlerën e

kontratave dhe referencave, ndërsa sa i përket pune se inxhinierit OE notetech nuk e plotëson këtë kriter për shkak se ka bachelor që tash është i vërtetuar edhe në raportin e ekspertit e ka hedh poshtë këtë pretendim edhe me vendim të OSHP-së të datës 15.12.2020.

Ndërsa për OE të rekomanduar për kontratë ai është inxhinier i elektroteknikës në kemi kërkuar inxhinier ose master që OE i shpallur fitues e plotëson këtë kriter të njëjtën e kemi edhe në vendimin e herës se kalua që nuk ka ky pretendim është i pa paqëndrueshëm.

AK i nderuar z. Ekspert në të dytën keni thanë që rezulton se i njëjti nuk e përmbush kërkesën e AK-së sepse e ka gradën bachelor dhe jo inxhinier siç kërkohet nga AK andaj edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm dmth për inxhinier që po flitni ju e keni thanë në raportin tuaj që është i pa qëndrueshëm.

AK në kërkesën për rishqyrtim OE ka ofruar diplomë të nivelit master i cili është mekatronikë edhe në nuk kemi pas nevojë me kërkua informata shtesë sepse i ka ofruar dokumentet të cilat ka pretenduar se i plotëson këtë kriter do të thotë ku e ka ofruar këtë diplomë e ka ofruar të një profili krejt tjetër të cilin ka të bëjë me mekatronikun nuk ka të bëjë me elektrotechnikun kjo është arsyeja pse nuk është kërkuar sqarime shtesë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti z. Hisenaj deklaroj: në lidhje me raportin e ekspertizës qëndrojmë mbrapa raportit të përpiluar për këtë aktivitet e prokurimit për faktin se nën 1 në lidhje me ankesën e OE Afajing konstatojmë sikurse edhe herën e parë se i njëjti ka ofruar një ISO certifikatë e cila ka të bëjë me ndërtimtari dhe nuk ka të bëjë fare me qëllimin e projektit i cili bëhet fjalë në teknologjinë informative kështu që bëhet fjalë për diçka krejt të kundërt me atë për të cilën i njëjti pra oferton dhe konsideroj që është e pa imagjinueshme të ofroj një ISO standard për ndërtimtari dhe të aplikoj për furnizim me teknologji informative.

Ndërsa në lidhje me OE node tech sikurse edhe vendimi i OSHP-së në bazë të dokumenteve të cilat ka ofruar OE në sivi të të njëjtit staf figuron se ai staf plotëson këtë kriter sepse ka edhe titullin master ashtu siç kërkohet nga OE pra në vendimin paraprak është obliguar AK që konform nenit 72 të kërkojë sqarime shtesë ndaj OE duke u bazuar e dhe në RRUOPP-në ndërsa AK nuk e ka zbatuar këtë nen dhe nuk ka kërkuar sqarime shtesë ndaj OE se a posedon apo nuk posedon bjer titull ky zyrtar i ofruar për këtë aktivitet të prokurimit ndërkaq dokumentet të cilat ka dëshmojnë se i njëjti mund të ketë këtë titull kjo ka qenë edhe arsyeja për çka kom kërkuar që kjo lëndë duhet të kthehet në rivlerësim për faktin sepse ka dëshmi të cilat tregojnë se i njëjti ka titullin master pavarësisht që të njëjtin nuk e ka pjesë të dosjes e njëjta është e vërtetuar me vendimin paraprak. Eksperti shqyrtues sqaron se (replikë) AK –së ju shikon në sivi të tina të cilën e keni pjesë të dosjes së tenderit ku figuron saktë se i njëjti posedon do të thotë titullin master në sivi të tina ndërkaq pikërisht për këtë pjesë në vendimin paraprak AK e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe ka kërkuar që konform nenit 72 të kërkojnë sqarime shtesë. Unë në bazë të dokumenteve në e-prokurimi nuk pash që ju si AK keni kërkuar sqarim shtesë në lidhje me këtë pikë kështu që nuk pas askund nëse ka diku atëherë na e tregoj ta ndryshojmë mendimin mirëpo unë nuk pash një pikë që i njëjti nuk e ka plotëson këtë kriter.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE "Node Tech".

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Kërkesa1- Kërkesa1- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar projekte të ngjashme në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerën prej së paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese të këtyre projekteve. Për këtë pikë ne kemi ofruar dëshmi Listën e projekteve dhe referencat dhe Referencat në vlerën: 155,624.80 euro d.m.th. ne kemi ofruar shumë më shumë dëshmi se sa është kërkuar, nëse për AK është diçka e pa kuartë në listën dhe dëshmi konform nenit 72 të LPP-së është dashur me kërkuar sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej: 4,942.50 euro.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se bazuar në Ofertën e OE Node Tech përkatësisht Listës së Kontratave/referencave të ofruar rezulton se Kontrata e ofruar dhe Referencat e plotësojnë kriterin sipas dosjes së Tenderit. Andaj konsideroi se ky pretendim është i Bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Kërkesa 2 - Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Staf i kualifikuar në fushën përkatëse, së paku -Një(1) Inxhinier të elektronikës, së paku 3 vite përvojë pune pas Diplomimit. Në këtë pikë fillimisht nuk keni kërkuar Inxhinier të diplomuar, po vetëm inxhinier, përkundër kësaj për këtë pikë ne kemi ofruar MASTER, z. Xhevat Berisha i cili me dëshmitë e tij i plotëson kërkesat e FDT-së. Në CV ju e keni vërejtur se ky inxhinier është Master, figuron në listë siç është kërkuar, nëse e keni patuar të pa qartë dhe këtë pikë është dashur konform nenit 72 të LPP-së të kërkonte diplomën Master të cilën po ua ofrojmë me këtë kërkesës për sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej 4,942.50 Euro Pas kërkesës për rishqyrtim nga ana jonë, për pikën e inxhinier të elektronikës për të cilën jemi eliminuar, çuditërisht në Vendimin e datës 06.11.2020 AK ka cekur se na mungon Inxhinier i Shkencave Kompjuter, për të cilën pikë ne kemi ofruar stafin dhe dëshmitë e për të cilën vet AK nuk ka kemi eliminuar, sepse dëshmitë janë pjesë e ofertës tone.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se bazuar në dokumentet e dosjes së ofertës për z. Xhevat Berisha, të njëjtit kanë ofruar dokumentacion si: Diplome Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Elektrik,

ku i njëjti mbanë datën e diplomimit me datë 03 dhjetor 2013 në Departamentin Elektronik, Bazuar ne kërkesat se dosjes se Tenderit: Kërkesa2 – Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku –Një (1) Inxhinier te elektronikes, se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit Një (1) Inxhinier i shkencave kompjuterike ,se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia2 - Kontratat e punës ose marrëveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV. Rezulton se i njëjti nuk përmbush kërkesën e AK-së pasi nuk plotëson kriterin bazë sepse ka Gradën Bachelor dhe jo Inxhinier ashtu siç edhe kërkohet në Kërkesën e AK-së.

Në lidhje me këtë pretendim ankimor OE do të duhej të parashtronte kërkesë për sqarime shtesë gjatë fazës së Njoftimit për kontratë dhe jo vetëm pas vlerësimit te Ofertave. Andaj konsideroj se ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet ankimore te OE “AFA-ING”

Lidhur me pretendimin e ankuesit se ne kemi plotësuar kërkesën e AK-së ISO Standard 9001:2015. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se bazuar në Ofertën e OE AFA-ING;”K-ING” sh.p.k, përkatësisht ISO Standard 9001:2015. OE në fjalë ka ofertuar me ISO Standard 9001:2015, Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave; Rrjete të ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimi i impianteve për trajtim të ujërave të zeza, rrugëve dhe urave. Ndërsa Projekti në fjalë ka të bëjë me Furnizim me Pajisje të TI-së, gjë që një Standard i tillë i ofruar nuk ka asnjë lidhshmëri me projektin, andaj konstatojmë se ky ISO Standard i ofruar nuk plotëson kërkesat për këtë projekt. OE “ Afaing” ka ofruar një ISO certifikata e cila ka te bej me ndërtimtari dhe nuk ka te bej fare me qëllimin e projektit i cili behet fjalë ne teknologjinë informative kështu qe behet fjalë për diçka krejt te kundërt me atë për te cilën i njëjti pra oferton dhe konstatojmë qe është e pa imagjinueshme te ofroj një ISO standard për ndërtimtari dhe te aplikoj për furnizim me teknologji informative.

Lidhur me pretendimin e ankuesit sa i përket arsyetimit te AK-së se nuk kemi ofruar dëshmitë lidhur me stafin, konkretisht me inxhinierin e shkencave kompjuterike, kërkojmë nga ju (AK) të verifikoni edhe një here sepse dëshmia lidhur me këtë inxhinier gjendet në ofertën tonë të dorëzuar në sistemin e e-prokurimit. dëshmitë për këtë inxhinier janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Përgjigje ne pretendimin Ankimor 2.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se OE në fjalë rezulton se për këtë projekt ka ofruar stafin si në vijim: Ardian Morina – Diplome e ciklit të parë të Studimeve Universitare. Në dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi të jetë Master apo ING ashtu siç kërkohet në FDT. Bilbil Haxhijaha –Bachelor of science

në dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi të jetë Master apo ING ashtu siç kërkohet në FDT. Florim Morina – Bachelor i shkencave të inxhinierisë elektrike, në dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi të jetë Master apo ING ashtu siç kërkohet në FDT. Izet Buzha – Inxhinieri i diplomuar i Elektronikës, Florian Mucolli - bazuar në CV e të njëjtit dhe dokumenteve përcjellëse rezultojnë se: Posedon diplomë Bachelor në drejtimin: Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, November 2012 (Working on Master Thesis) – nuk ka dëshmi se ka të përfunduar Master. Konsideroj se në lidhje me këtë. Andaj paneli shqyrtues konstaton se OE në fjalë nuk ka ofruar dëshmi konform kërkesës se cekur si më lart, e që ky fakt operatorin e ekonomik në fjalë e bën të pa përgjegjshëm .

Lidhur me deklarinimin e përfaqësuesit të OE “N.T.SH “NODE TECH ” - Suharekë se pas kërkesës që në kemi bërë për qasje në dokumente të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, në kemi vënë në dijeni që OE i propozoj për shpërblym me kontratë posedon një diplomë pikërisht inxhinier i elektroteknikës, a në certifikatën është inxhinier i elektroteknikës gjë që e ndryshon, posedon një diplomë të shkollës së lartë e cila nuk është e barasvlerëshme as për inxhinierin e propozuar nga ana jone, deklarim ky i dhënë në seancën për shqyrtim kryesor të mbajtur përmes platformës Zoom, paneli shqyrtues konstaton se AK në dosjen e tenderit ka kërkuar: Kërkesa2 – Kualifikimet shkollë dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Staf i kualifikuar në fushën përkatëse, së paku –Një (1) Inxhinier të elektronikës, së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit Një (1) Inxhinier i shkencave kompjuterike ,së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia2 - Kontratat e punës ose marrëveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV. Duke pasqyruar faktin se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për inxhinierin e elektroteknikës ka ofruar një diplomë të shkollës së lartë për inxhinier të elektronikës e jo të elektroteknikës, e që në bazë të kësaj dëshmie që i prezanton OE në fjalë paneli konstaton se as OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk plotëson kërkesën e AK-së të cekur si më lart (së paku Një (1) Inxhinier të elektronikës, së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit Një (1) Inxhinier i shkencave kompjuterike, së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se, duke pasqyruar faktin se as operatorët ekonomik ankues e as operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk plotësojnë kërkesat e AK ashtu siç është kërkuar në FDT- e po ashtu AK nuk ka ofertues tjerë të përgjegjshëm, konstatojmë se në pajtim me nenin 62 të LPP-se dhe nenin 44 të RRUOPP aktiviteti i prokurimit në fjalë e duhet të anulohet, dhe AK nëse e dhe me tutje ka interes për aktivitetin e prokurimit në fjalë të njëjtin mund ta ritenderoi konform dispozitave të LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 62 i LPP-së dhe neni 44 i RRUOPP. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që aktiviteti i prokurimit në fjalë të anulohet në pajtim me nenin 62 të LPP -së dhe nenin 44 të RRUOPP.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "Komuna Suharekë";
- 1x1 OE N.T.SH "NODE TECH" – Suharekë;
- 1x1 OE N.P.SH "AFA ING KING" sh.p.k- Suharekë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.